



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura V  
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit  
SP-091  
Prishtinë, më 19 janar 2017

**PROCESVERBAL**

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 19 JANAR 2017**

Seancën e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, i ndihmuar nga nënkryetarët: Sabri Hamiti dhe Aida Dërguti.

Nënkryetari i hapi punimet e Sesionit pranveror dhe të kësaj seance plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Bekim Haxhiu, Nuredin Ibishi, Glauk Konjufca, Pal Lekaj, Valdete Bajrami, Flora Brovina dhe Njomza Emini, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti Nezir Çoçaj i parashtrori pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferat Shala, në lidhje me masat e ndërmarra për mbrojtjen e shtratit të lumit Drini i Bardhë. Ministri Ferat Shala nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Nezir Çoçaj i parashtrori pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me trajnimet profesionale të edukatorëve të çerdheve private si dhe shpërndarjen e dokumenteve dhe materialeve të MASHT-it te këto institucione. Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrori pyetje ministrit të Financave, Avdullah Hoti, në lidhje me pagesat që bizneset e Kosovës i bëjnë gjatë kalimit të mallit transit në Republikën e Shqipërisë. Ministri Avdullah Hoti nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrori pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me furnizimin me barna dhe ushqim në SHSKUK. Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrori pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me sigurinë në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë, konkretisht te fshatrat Miradi e Ulët dhe Vragoli. Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj i parashtrori pyetje ministrit të Financave, Avdullah Hoti, në lidhje me lirimimin nga pagesa e tatimit në pronë për kategori të caktuara të shoqërisë sipas ligjeve në fuqi. Ministri Avdullah Hoti nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Abdyl Ymeri i parashtrori pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenie Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me përmirësimin e statusit të pensionistëve nëpërmjet dispozitave ligjore. Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Kimete Bytyçi i parashtrori pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me nostrifikimin e diplomave të qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë diplomuar në universitetet e Republikës së Shqipërisë. Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Lahi Brahimaj i parashtrori pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me dëmtimin e urës në Rakovinë, në magjistralen Prishtinë-Gjakovë. Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrori pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me asfaltimin e rrugës së fshatit Demjan të komunës së Gjakovës.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me planifikimin e asfaltimit të rrugës që lidh komunën e Gjakovës dhe komunën e Junikut.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Fikrim Damka i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala, në lidhje me ndërtimin e xhamisë dhe Sahat Kullës në Kalanë e Prizrenit.

Ministri Kujtim Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, në lidhje me pajisjen e Policisë së Kosovës me helikopterë.

Ministri Skënder Hyseni iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me situatën e 18 studentëve të regjionit të Gjilanit për vazhdimin e studimeve në Universitetin e Prishtinës.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Zafir Berisha i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me respektimin e vendimeve të Qeverisë së Kosovës nga ana e pushteteve lokale.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Haxhi Shala i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me formimin e Komisionit për përcaktimit e shkallës së invalidëve të luftës së UÇK-së.

Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Mufera Shinik i parashtrroi pyetje ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, në lidhje me ratifikimin e Marrëveshjes për tregtinë e lirë në mes të Kosovës dhe Turqisë.

Ministrja Hykmete Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Daut Haradinaj i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me nismën ligjore për ndërrimin e misionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Labinotë Demi-Murtezi i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me platformën e re të MASHT-it për përmirësimin e cilësisë së arsimit në Kosovë.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Labinotë Demi-Murtezi i parashtrori pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me lehtësimin e infrastrukturës për udhëtimin më të lehtë për mësimdhënësit në viset rurale.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Abdyl Ymeri i parashtrori pyetje ministres për Dialog, Edita Tahiri, në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Kosovës.

Ministrja Edita Tahiri nuk ishte e pranishme në sallë.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 20, 22, 23, 24, 29 dhe 30 dhjetor 2016.

### **4. Interpelanca e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë**

Kryesuesi i seancës, Sabri Hamiti, i njoftoi deputetët se Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti Ismajl Kurteshi në fjalimin e tij, duke e përshkruar gjendjen e arsimit në Kosovë theksoi se sipas rezultateve të testit ndërkombëtar të PISA-s Kosova është radhitur e fundit në mesin e 72 vendeve që kanë marrë pjesë në testin ndërkombëtar.

Kjo gjendje, që vjen si pasojë e mungesës së angazhimit të duhur në fushën e arsimit të të gjitha qeverive të pasluftës, ndërhyrjes së politikanëve në fushën e arsimit për përfitime politike, personale ose grupore, për vota ose blerje të përkohshme të qetësisë sociale, është edhe rezultat i bartjes së kompetencave nga profesionistët nëpër shkolla në duar të politikanëve.

Për këtë gjendje fajin e bartin edhe shumë aktorë që kanë punuar në fushën e arsimit gjatë viteve të pasluftës, por përgjegjësi e veçantë bie mbi qeveritë, drejtoritë komunale të arsimit, udhëheqjet komunale dhe drejtorë të shkollave, të cilët nuk kanë punuar mjaftueshëm ose nuk kanë ditur të punojnë si duhet për të arritur rezultate të mira.

Kjo situatë, e bazuar në vlerësimin e PISA-s, duhet të na shërbejë si një moment kur ne të gjithë e kuptojmë se cilësia në arsim nuk arrihet me vlerësime joreale të nxënësve, as me deklarata pompoze të ministrave, as me strategji të kushtueshme e që nuk prodhojnë rezultate të kënaqshme, as me kurrikula që pa i përdorur po fillojmë t'i ndryshojmë, as me tekste të papërshtatshme shkollore, as me universitete të fushatave elektorale e kolegje me licenca të dyshimta.

Për të dalë nga kjo situatë, shtoi deputeti Ismajl Kurteshi, prindërit duhet të bashkëpunojnë shumë më shumë se në të kaluarën me mësimdhënësit. Prindërit nuk duhet të kërkojnë nga mësimdhënësit nota më të larta për fëmijët e tyre, por duhet të kërkojnë llogari nga mësimdhënësit nëse fëmijët e tyre nuk e dinë tabelën e shumëzimit, nëse fëmijët e tyre nuk dinë të lexojnë, nëse nuk është mbajtur ora e fundit e mësimit, nëse mësimi praktik nuk organizohet si duhet, nëse arsimtarët nuk mbajnë orë kujdestarie dhe mbledhje me prind.

Qeveria e Kosovës nuk guxon të kursejë buxhet në dëm të cilësisë në arsim. Synim i Qeverisë duhet të jetë ngritja e cilësisë, furnizimi i shkollave me mjete pune, krijimi i kushteve për mësim tërëditor, e të tjera.

Drejtoritë e shkollave, drejtoritë komunale të arsimit dhe Ministria e Arsimit duhet të sigurojnë respektimin e kriterëve të punësimit bazuar në aftësitë profesionale, kurse mësimdhënësit e rinj në të ardhmen duhet të kalojnë së paku 1 vit në punë provuese, para se të fitojnë statusin e mësimdhënësit të rregullt.

Inspektorët e arsimit dhe mekanizmat e tjerë profesionalë duhet të përcjellin punën në secilën hallkë të arsimit, të vlerësojnë atë me profesionalizëm dhe pa anime.

Tekstet shkollore duhet të rikonceptohen, kurse tekstet antikushtetuese duhet të largohen nga shkollat tona. Nxënësit duhet të orientohen bazuar në aftësitë e tyre personale dhe nevojën e tregut të punës. Diskutimi i plotë i deputetit Ismajl Kurteshi është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Kosovës në lidhje me çështjet e ngritura në këtë interpelancë.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami, tha se për të reflektuar ndaj vlerësimit të PISA-s, i cili ka ndodhur vetëm 3 muaj pas fillimit të këtij mandati, duhet vepruar që ngritja e cilësisë në sistemin arsimor të jetë prioritet kombëtar. MASHT-i do ta procedojë në Kuvend për miratim një kornizë të një programi kombëtar për edukim dhe arsim, i cili do të bëhet një dokument afatgjatë. Ai këtë program e paraqiti në dhjetë shtylla, si në vijim:

**Shtylla e parë**, një sistem i suksesshëm arsimor fillon pikërisht te moshat e hershme dhe objektivi numër një është gjithëpërfshirja në arsimin parafillor dhe parashkollor, sepse akoma jemi larg standardeve ndërkombëtare sa i përket përfshirjes së fëmijëve tanë,

sidomos në grupmoshat prej 3 deri në moshën 6-vjeç, për shkak se mungojnë kapacitetet dhe ne duhet të rrisim investimet për një gjithëpërfshirje.

**Shtylla e dytë** e këtij programi që po zbatohet që dy vjet **është kurrikula**, sepse PISA 2015 reflektoi kurrikulën e vjetër, e bazuar kryesisht në mësim teorik, në një mësimdhënie memorizuese. Ne nga viti 2011 kemi filluar me kurrikulën e re evropiane, e cila tërësisht bazohet në kompetenca dhe në shkathtësi, e cila është një rishikim substancial i komplet sistemit arsimor. Programet mësimore, lënda, kurrikula është komplekse dhe ka dhjetë komponentë dhe tenton ta transformojë tërësisht shkollën tonë parauniversitare për ta bërë një shkollë praktike dhe për të përgatitur nxënës që nesër do të mund të kyçen lehtë në arsimin e mesëm dhe në arsimin universitar, një kurrikulë që bazohet në tri shtylla kryesore: E para, ndërrimin e balancës mes mësimin teorik e mësimin praktik, e kurrikula e re zvogëlon për 50% vëllimin e mësimin teorik dhe për 50% ngrit mësimin praktik. Elementi i dytë i kurrikulës është përgatitja e mirë e mësimdhënësve, të cilët do të punojnë me kapacitete profesionale dhe pedagogjike për të ofruar një mësimdhënie çfarë u duhet nxënësve tanë, për t'i liruuar nxënësit nga përmbytje që asnjëherë nuk do t'u duhen në jetë dhe për t'u dhënë aftësi kreative, aftësi të gjykitimit kreativ dhe aftësi në ndërtimin e personalitetit.

**Shtylla e tretë** është problematika e teksteve mësimore, sepse së fundi, vlen parimi se nxënësit janë të tillë çfarë tekstesh u ofrojmë ne. Sa i përket problematikës së teksteve shkollore po punohet në tri drejtime. E para, ajo çfarë ka filluar dhe do të rezultojë me tre muajt e parë të këtij viti është standardizimi i teksteve të shkencave të natyrës, duke sjellë në Kosovë tekste unike me standarde ndërkombëtare, sepse definitivisht matematika, fizika, kimia dhe biologjia janë lëndë universale dhe ato duhet të jenë standarde. Reforma e dytë sa i përket teksteve do të jetë promovimi hap pas hapi i tekstit digjital. Ne sivjet do të promovojmë portalin kombëtar shtetëror “E-edukimi”, ku do të fillojë dalëngadalë kalimi nga teksti manual, klasik, në atë digjital dhe kjo do të mundësojë pa dyshim edhe zvogëlimin e problemit të çantave të rënda, por do të mundësojë edhe qasjen më të lehtë të nxënësve në tekstin digjital. Elementi i tretë është rishikimi permanent i teksteve çdo vit shkollor, jo një herë në 15 vjet. Por, dëshirojmë që çdo vit shkollor ne t'i rishikojmë tekstet ekzistuese, në mënyrë që të jemi të sigurt se ato tekste kanë përmbytje çfarë u duhet nxënësve tanë.

**Shtylla e katërt** është përballja me epokën e digjitalizimit apo modernizimi i sistemit arsimor. Jemi duke jetuar në kohën e teknologjive të informacionit, ku interneti po bëhet një mjet i domosdoshëm për mësimdhënie moderne. Do të promovohet portali “E-edukimi”, i cili përmban të gjitha komponentët, përfshirë ditarin elektronik, tekstin elektronik, mësimdhënien elektronike, debatin elektronik, lidhjen mes shkollës dhe prindërve, komunikimin mes shkollës dhe prindërve.

**Shtylla e pestë**, mekanizimi i ngritjes së cilësisë në shkollë. Çfarë kemi bërë për ta ngritur cilësinë? Fillimisht janë miratuar dy dokumente kombëtare, strategjike dhe është një model i një qasjeje gjithëpërfshirëse, sepse politikat arsimore janë politika kombëtare. Kemi miratuar strategjinë kombëtare për ngritjen e cilësisë në vitin e kaluar dhe vetëm një ditë pas

vlerësimet ndërkombëtar PISA Qeveria ka miratuar Planin strategjik për zhvillimin e arsimit në periudhën 2017-2021. Cilësia e arsimit duhet të rritet dhe të ndërtohet brenda shkollave. Nuk do të mjaftojnë strategjitë tona në qoftë se brenda shkollës nuk e kemi çelësin se si ta motivojmë shkollën që ajo të ngritë cilësinë. Strategjia për ngritjen e cilësisë nisët pikërisht nga shkolla, duke u dhënë përgjegjësinë kryesore drejtorit të shkollë, koordinatorit për cilësi, të gjithë mësimehdhënësve, duke faktorizuar prindërit si aksionarë të shkollës. Ne kemi zhvilluar projektin evropian “Ndërtimi i karrierës gjatë gjithë jetës” dhe do fillojmë me procesin e gradimit të mësimehdhënësit, që ai të avancohen sipas performansës, cilësisë dhe që ta stimulojmë mësimehdhënësit të ngritin karrierën. Duhet ta krijojmë kushte që mësimehdhënësit të stimuloohen për t’i ngritur pagat.

**Shtylla e gjashtë** është përshtatja komplet e sistemit arsimor nevojave të tregut të punës. Sot, në kushte moderne, arsimit nuk është asgjë tjetër veçse ekonomi dhe arsimit duhet t’u përshtatet tërësisht nevojave të tregut të punës. Kemi filluar implementimin e një projekti të madh evropian, i cili do të tregojë se cilat janë gjasat e punësimit në Republikën e Kosovës në nivel kombëtar dhe në nivel komunal në pesë vjetët e ardhshme. Dhe, varësisht nga ky studim, ne do të orientojmë programet në shkollat tona. Ne kemi mbingarkesë në disa drejtime dhe kemi mungesë kuadrosh në disa drejtime të reja, sidomos në sferën e teknologjisë së informacionit.

**Shtylla e shtatë** është reformimi i Inspektoratit të Arsimit. Me projektligjin që është në procedurë parlamentare synojmë të kemi një inspektorat kompetent, kredibil, profesional dhe të besueshëm në opinion, i cili do të jetë një monitorues i mirë i gjendjes në arsim, do të jetë një ofruer i këshillave dhe ndihmës në sistemin arsimor, në mënyrë që vërtet të kemi një sistem të llogaridhënies, të përmirësimit të defekteve në proces, të një pasqyre të vërtetë të gjendjes arsimore.

**Shtylla e tetë** është arsimit i lartë, *i cili përmban tri nënshtylla* që përmban Plani strategjik për arsimin e lartë.

Çështja e parë që ka bërë Ministria e Arsimit për arsimin i lartë është fillimi i procesit të specializimit të universiteteve publike dhe të përshtatjes së programeve të këtyre universiteteve nevojave të tregut të punës, në mënyrë që të mos kemi përsëritje të programeve, por që universitetet e raja që janë themeluar në rajonet e vendit të lidhen me nevojat e zhvillimit rajonal dhe të zhvillimit ekonomik të tyre.

Çështje të dytë kemi vendosur pranimin e studentëve në arsimin e lartë sipas rezultateve të arritura në arsimin paraprak dhe normave të caktuara për pranimin e numrit të studentëve.

Çështja e tretë ka të bëjë me çështjet e financimit. Përvojat e universiteteve ndërkombëtare tregojnë se universitetet janë promotorë të zhvillimit ekonomik, lidhen me ekonomi, janë partnerë të ekonomive, gjë që neve na mungon. Duhet të gjejnë format komplementare e suplementare të financimit. Ato duhet të lidhen me ekonomi, me industri, që të gjenerojnë të ardhura. Ministria e Arsimit po e zhvillon një projekt të financimit, ku universitetet publike do të financohen në proporcion me performansën e tyre.

Në fund, ministri Arsim Bajrami shtoi se arsimi është një fushë që e paraqet preokupimin kryesor kombëtar, si dhe shprehu gatishmërinë të diskutohen çdo tre muaj çështjet e arsimit, ku ai do të raportojë para deputetëve.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e ministrit Arsim Bajrami.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan këta deputetë: Bekim Haxhiu, në emër të GP të PDK-së; Salih Morina, në emër të GP të LDK-së; Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Shukrije Bytyçi, në emër të GP të “Nismës”, Mufeta Shiniq, në emër të GP “6+” si dhe deputetët: Gëzim Kelmendi, Selvije Halimi, Melihate Tërmkollu, Mytaher Haskuka, Time Kadrijaj, Qerim Bajrami, Xhevahire Izmaqi, Shpejtim Bulliqi, Abdyl Ymeri, Driton Çausi, Agim Aliu, Kimete Bytyçi, Salih Salihu, Raif Qela, Veton Berisha, Mexhide Mjaku-Topalli dhe Safete Hadërgjonaj, diskutimet e të cilëve të plotë janë dhënë në transkript.

Në fund të debatit, në emër të propozuesit të interpelancës, deputeti Ismajl Kurteshi e paraqiti për miratim tekstin e propozim-rezolutës prej 12 pikave, të harmonizuar edhe nga grupet e tjera parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për ta hedhur në votim propozim-rezolutën. Votimi i saj shtyhet për seancën e radhës.

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-132 për automjete**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Infrastrukturës, z. Lutfi Zharku, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për automjete diskutuan: Fatmir Rexhepi, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala, në emër GP të PDK-së, Blerim Grainca, në emër GP të LDK-së, Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së, Rrustem Berisha, në emër të GP të AAK-së, Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma”, si dhe deputeti Raif Qela, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për automjete.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 57,



Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-132 për automjete.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

#### **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive diskutuan: Fatmir Shurdhaj, në emër të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Ganimete Musliu, në emër GP të PDK-së, Anton Çuni, në emër GP të LDK-së, Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së, Duat Haradinaj, në emër të GP të AAK-së dhe Zafir Berisha, në emër të GP "Nisma", diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 61,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive.

2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Deputeti Agim Aliu, në emër të Komisionit FunkSIONAL, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në projektligj ishin propozuar 36 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL.

Kryesuesi i hodhi në votim përnjëherë amendamentet prej 1-36, të cilat edhe i miratoi Kuvendi.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 52,  
Kundër----- 00,  
Abstenime-----12.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

### **V E N D I M**

Miratohet Ligji nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë.

## **8. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë ka kërkuar debatin parlamentar lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si dhe e ka propozuar për miratim një propozim-rezolutë, e cila u është shpërndarë deputetëve.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LVV-së, Glauk Konjufca, propozoi që debati lidhur me këtë çështje të shtyhet për të nesërmen, me arsyetimin se nuk mjafton koha e pasdites së vonshme për këtë debat.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare të PDK-së, LDK-së dhe “6+” kërkuan që seanca t'i zhvillojë punimet sipas rendit të ditës.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një të dy propozimet e lartshënuara, por nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Më pas, Kryesuesi procedoi me debatin parlamentar.

Kryesuesi e ftoi parashtruesin e mocionit për debat parlamentar që ta paraqesë dhe ta arsyetojë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Kryetari i GP të LVV-së, Glauk Konjufca, tha se në Republikën e Kosovës ekziston një projekt shumë i qartë i pushtetit, i Qeverisë së Kosovës, në raport me subjektin më të madh opozitar në këtë vend që Lëvizja “Vetëvendosje” të përjashtohet prej politikës. Kjo ka qenë një përpjekje e vazhdueshme e pushtetit, e cila edhe sot e kësaj dite po vazhdon, që Lëvizjen “Vetëvendosje” ta diskualifikojë nga politika nëpërmjet kategorizimit si organizatë terroriste. Kjo përpjekje e Qeverisë është kristalizuar më qartë, pra ka marrë formë konkrete më 28 nëntor të vitit 2015, kur dikush nga Qeveria ka marrë vendim që zyrat e subjektit më të madh opozitar në vend të thyhen nëpërmjet aktivizimit të njësitit antiterrorist, i përbërë prej 36 vetëve, i cili ka hyrë në zyrat e Lëvizjes “Vetëvendosje” me një brutalitet dhe dhunë, e cila nuk është parë në Kosovë moti.

Dhe, kështu kronologjikisht vijmë te 4 gushti, një sulm i papranueshëm që i ka ndodhur Kuvendit të Republikës së Kosovës, një sulm me predhë i drejtuar kundër Republikës së Kosovës, kundër institucioneve të shtetit tonë dhe të cilin krejt bashkërisht e kemi konsideruar të papranueshëm dhe e kemi dënuar. Mirëpo, pushteti te ky sulm e ka parë një rast të jashtëzakonshëm, një rast të përkryer që t’ia veshë Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe më 30 gusht, menjëherë pas tri javësh ka nisur kjo fushatë e pushtetit që t’ia veshë Lëvizjes “Vetëvendosje” këtë sulm dhe Policia e Kosovës i ka arrestuar gjashtë aktivistë, që janë: Astrit Dehari, tashmë i ndjerë, i cili e gjeti vdekjen në burgun e Prizrenit, Frashër Krasniqi, Adea Batusha, Egzon Haliti, Atdhe Arifi si dhe Petrit Ademi.

Që prej atij momenti Prokuroria, e cila merret me rastin e tyre, ka dështuar në aktakuzën e saj dhe ka dështuar të argumentojë se këta vërtet janë njerëzit të cilët qëndrojnë prapa sulmit të Kuvendit të Kosovës më 4 gusht të vitit të kaluar.

Rezultati i fundit i Forenzikës tregon që nuk ka asnjë lidhje në mes të këtyre aktivistëve të akuzuar dhe të gjitha gjetjeve të çdo gjëje që është konfiskuar, edhe nëpër shtëpitë e tyre, edhe në vendin e ngjarjes dhe çdo provë që është ofruar nuk ka lidhje me këtë rast.

Qëllimi i aktakuzës që është ngritur më 29 dhjetor të vitit të kaluar nuk ka qenë gjetja e fajtorit, faktikisht identifikimi konkret i sulmuesit. Aktakuza është për t’ia veshur dhe për t’i mbetur një etiketë “Vetëvendosjes” si subjekt terrorist. Diskutimi i plotë i deputetit Glauk Konjufca është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për çështjen e shtruar.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar për debat parlamentar, diskutuan: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP të “Nismës”, ministri Skender Hyseni, si dhe deputetët: Anton Quni, Visar Ymeri, Daut Haradinaj, Haxhi Shala, Albulena Haxhiu, Besa Gaxheri,

Besa Baftiu, Time Kadrijaj, Donika Kadaj-Bujupi, Sabri Hamiti, Ismajl Kurteshi, Albin Kurti dhe Shaip Muja, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund të këtij debati kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për ta hedhur në votim propozim-rezolutën e propozuar nga parashtruesi i kërkesës për debat parlamentar.

Ai tha se votimi i pikave të papërfunduara të kësaj seance plenare do të procedohen në seancën plenare të radhës.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 20:35 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit

Xhavit HALITI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*